



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT**

Nr. 318/16 Prot.

Tiranë, më 26.3.2018

VENDIM

Nr. 14, datë 26.3.2018

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Qendra “Lex Ferenda”, përfaqësuar nga Znj. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur “Komisioneri”) ankimin nr. 318 Prot., datë 09.02.2018, kundër Autoritetit Publik “Komisionit të Pavarur të Kualifikimit” (në vijim quajtur “Autoriteti Publik”), me objekt “*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*”.

Me anë të kërkesës së datës 22.01.2018, Qendra “Lex Ferenda” ka kërkuar nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dokumentacionin dhe informacionin si më poshtë vijon:

1. Kopje të çdo vendimi (ose ekstrakti nga procesverbali i mbledhjes) të marrë nga mbledhja e komisionit, në kuptim të nenit 9 të rregullores për veprimtarinë e Komisionit të Pavarur të kualifikimit.
2. Numrin e çështjeve të regjistruara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe trupat gjyquese të cilëve i janë shpërndarë çështjet, duke përcaktuar të dhënat për çështjen, trupën gjyquese dhe relatorin.
3. Datën e seancës dëgjimore. Nëse nuk është caktuar, kur mund të zhvillohen?

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, i është përgjigjur ankuesit nëpërmjet shkresës nr.1174 Prot., datë 29.01.2018 duke vënë në dispozicion pjesërisht informacionin e kërkuar.

Konkretisht në përgjigjen e kthyer për pikën e parë të kërkesës sqarohet se: “*Disa nga aktet e parashikuara për t’u miratuar nga Mbledhja e Komisionit, janë ende në proces shqyrtimi, sapo të merret vendimi përkatës, këto akte do të bëhen publike. Gjithashtu sqarohet se jo të gjitha vendimet e kësaj mbledhje mund të bëhen publike, duke patur parasysh se disa*

informacione të përpunuara në këto mbledhje, po të bëhen publike në fazën aktuale "shkaktojnë një dëm të qartë dhe të rëndë për administrimin e procesit të rivlerësimit", në kuptim të nenit 4/7 të ligjit nr. 84/2016."

Lidhur me pikën dy të kërkesës, në përgjigje sqarohet se: "Komisioni i Pavarur i Kualifikimit nuk regjistron çështje, por shorton listën e subjekteve të rivlerësimit, për të cilat mbledhja merr vendim. Në bazë të rregullores shorti do të hidhet çdo datë 15 të muajit. Lista e subjekteve që do të shorohen, miratohet nga Mbledhja e Komisionit. Kjo listë gjendet e publikuar në faqen zyrtare dhe përditësohet sa herë që hidhet shorti."

Lidhur me pikën 3 të kërkesës, Autoriteti Publik ka sqaruar se datat e seancave dëgjimore nuk janë caktuar dhe se do të publikohen në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit sapo të caktohen. Në përfundim sqarohet se dhënia e informacionit në këtë moment kushtëzohet nga faza procedurale në të cilën ndodhet procesi.

Me pretendimin se është cënuar në të drejtën për informim, ankuesi ka paraqitur ankim pranë Zyrës së Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri, me Urdhrin nr.78 datë 23.02.2018, vendosi fillimin e hetimit administrativ pranë Autoritetit Publik me qëllim verifikimin e fakteve dhe rrethanave që mund të jenë bërë pengesë për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar.

Gjatë inspektimit, përfaqësuesit e Autoritetit Publik sqaruan grupin e inspektimit se kërkuesit i është kthyer përgjigje duke i vendosur në dispozicion informacionin e kërkuar, në atë masë që dhënia e informacionit nuk cënon mbarëvajtjen e procesit të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në përputhje me parimin e proporcionalitetit të parashikuar dhe nga vetë ligji që rregullon këtë proces.

Lidhur me pikën 1 të kërkesës, Autoriteti Publik ka sqaruar se: "Të gjitha vendimet e Mbledhjes së Komisionit, që paraqesin interes për publikun në kuadër të transparencës së punës sonë, dhe që nuk cenojnë mbarëvajtjen e procesit të rivlerësimit në kuptim të nenit 4, pika 7 e Ligjit nr.84/2016, janë të publikuara në faqen tonë zyrtare. Një pjesë e vendimeve të Mbledhjeve të Komisionit nuk mund të bëhen publike, në fazën aktuale pasi në vlerësimin e këtij të fundit "shkaktojnë një dëm të qartë dhe të rëndë për administrimin e procesit të rivlerësimit", në kuptim të nenit 4/7 të ligjit nr.84/2016. Gjithashtu sa i përket vendimeve të Komisionit lidhur me subjektet e rivlerësimit, ato do të merren dhe publikohen sipas afatit të përcaktuar në nenin 55/7 të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Bazuar në nenin 55, pika 7 e ligjit 84/2016, vendimi me shkrim i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore. Vendimi publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit.

Lidhur me pikën 2 të kërkesës Autoriteti Publik mbajti të njëjtin qëndrim të shprehur edhe në përgjigjen dërguar ankuesit, duke shtuar përpara grupit të inspektimit se: "Regjistrimi i çështjeve në një regjistër për efekt organizimi të brendshëm kryhet vetëm pasi është hedhur shorti. Numri i përgjithshëm çështjeve mund të nxirret nga numri total i subjekteve të shortuar të publikuara në faqen zyrtare".

Sa i përket të dhënave mbi trupat gjykuese, kryesuesin dhe relatorin, bazuar në nenin 4/7 të ligjit nr. 84/2016, Autoriteti Publik ka vlerësuar ruajtjen e konfidencialitetit deri në njoftimin e seancës dëgjimore. Kjo për shkak se, në vlerësim të Komisionit, bërja publike e trupës

gjykuese përpara mbylljes së hetimit dhe njoftimit të seancës dëgjimore mund të cënojë procesin e hetimit. Duke gjykuar se këto informacione, në fazën aktuale, nuk mund të jepen, pasi *"mund të shkaktojë një dëm të qartë dhe të rëndë për procesin e rivlerësimit"*, informacioni do të jetë i aksesueshëm për publikun, pas njoftimit të subjektit të rivlerësimit për zhvillimin e seancës dëgjimore.

Lidhur me pikën 3 të kërkesës, Autoriteti Publik sqaroi se datat e seancave dëgjimore ende nuk janë caktuar dhe se nuk mund të ketë një afat indikativ se kur mund të caktohen pasi përfundimi i procesit të hetimit nuk varet vetëm nga Komisioni, por edhe nga faktorë të jashtëm që janë jashtë kontrollit të këtij të fundit. Sapo të mbyllet procesi i hetimit dhe të caktohen seancat e para, ato do të publikohen në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Bazuar në nenin 55 të ligjit 84/2016, Komisioni fton subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore, në përputhje me rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative. Vëzhguesit ndërkombëtarë njoftohen paraprakisht për zhvillimin e seancës dëgjimore. Seanca dëgjimore e Komisionit është publike dhe zhvillohet në përputhje me nenin 20 të ligjit 49/2012 *"Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative"*.

Me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv si dhe në zbatim të nenit 24/3 të Ligjit për të Drejtën e Informimit" në të cilin shprehimisht thuhet se *"...me marrjen e ankesës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ... kur e sheh të nevojshme, zhvillon një seancë dëgjimore publike me pjesëmarrjen e palëve"*, Komisioneri zhvilloi një seancë dëgjimore me datë 15.03.2018. Gjatë seancës dëgjimore asistoi në cilësinë e vëzhguesit edhe një përfaqësues i Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit. Gjatë seancës dëgjimore pala ankuese u shpreh se i qëndron pretendimeve të shprehura në ankesë.

Nga ana e tyre edhe përfaqësuesit e Autoritetit Publik u shprehën gjithashtu se i qëndrojnë argumenteve të parashtruara në shkresën kthim përgjigje dhe procesverbalin e mbajtur gjatë inspektimit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se në shqyrtimin e çështjes gjejnë zbatim dispozitat e Kushtetutës të cilat rregullojnë të drejtën e informimit, ato të Aneksit të saj mbi rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, si dhe të ligjit nr. 84/2016 *"Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"*.

Lidhur me pikën e parë të kërkesës, nga kontrolli i faqes zyrtare të institucionit rezulton të jenë publikuar disa prej Vendimeve të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit. Megjithatë Autoriteti Publik ka deklaruar se pjesë e vendimeve nuk mund të publikohen bazuar në nenin 4, pika 7 e ligjit nr. 84/2016 *"Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"*, sipas të cilit *"...e drejta e informimit, e parashikuar në ligjin "Mbi të drejtën e informimit", mund të kufizohet duke respektuar parimin e proporcionalitetit nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë për administrimin e procesit të rivlerësimit"*.

Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës, qëllimi i ngritjes së procesit të rivlerësimit është garantimi i funksionimit të shtetit të së drejtës si dhe rikthimi i besimit të publikut tek institucionet e sistemit të drejtësisë. Ky është dhe qëllimi i ligjit nr. 84/2016 *"Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"* sipas nenit 1 të tij.

Bazuar në nenin C të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit ushtrojnë përgjegjësitë e tyre bazuar në parimet e llogaridhënies, integritetit dhe transparencës për krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe profesional të çliruar nga korrupsioni.

Neni Ç i Ankesit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcakton ndër të tjera detyrimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Kolegji të Posaçëm të Apelit për të publikuar vendimet e tyre.

Përmbajtja e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" përcakton shprehimisht se (vetëm) bisedimet e Komisionit për marrjen e vendimeve bëhen me dyer të mbyllura. Pra fryma e përgjithshme që karakterizon këtë ligj është ajo e transparencës në veprimtarinë administrative dhe vendimmarrëse të institucioneve të rivlerësimit si një kusht themelor për një proces të besueshëm dhe në përputhje me pritshmërinë e publikut.

Nga ana tjetër e drejta e informimit është një e drejtë themelore e njohur dhe e mbrojtur nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë në nenin 23 të saj. Si e tillë ajo cilësohet nga neni 15 i Kushtetutës si e pandashme, e patjetërsueshme dhe e padhunueshme dhe si themel i rendit juridik. Sipas paragrafit të dytë të këtij neni organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si dhe të kontribuojnë në respektimin e tyre.

Si një e drejtë kushtetuese ky rregullim është i një karakteri të përgjithshëm dhe është rregulluar më tej me ligjin e posaçëm 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Në kuadrin e një procesi specifik dhe me një impakt të gjerë publik siç është procesi i rivlerësimit në sistemin gjyqësor, kjo e drejtë merr një domethënie tjetër, edhe më të rëndësishme se ajo që i vishet në një kontekst të zakonshëm. Nëse qëllimi i procesit të rivlerësimit të sistemit gjyqësor është ai i rikthimit të besimit të publikut tek ky sistem, ky qëllim nuk mund të realizohet përmes një procesi jo transparent qoftë edhe në detaje të tij. Në asnjë pasazh të Aneksit të Kushtetutës apo të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" nuk ndeshemi me frymën e mungesës së transparencës në ushtrimin e veprimtarisë së institucioneve të rivlerësimit. Dhe kjo frymë duhet përcjellë edhe në qasjen në praktikë të këtyre institucioneve ndaj interesit të shfaqur nga publiku. Kjo frymë karakterizon po ashtu edhe Rregulloren e Autoritetit Publik të miratuar në përputhje me nenin 69 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

Neni 9 i saj përcakton kompetencat që ushtron mbledhja e Komisionit. Gjithashtu në nenin 13 të kësaj Rregulloreje përcaktohet procedura e dokumentimit të mbledhjes së Komisionit. Në dispozitat e sipërcituara nuk konstatohen elementë, publikimi i të cilëve do të cënonte procesin e rivlerësimit, përkundrazi ato rregullojnë procedurat administrative që ndjek autoriteti publik.

Në këtë këndvështrim, Komisioneri vlerëson se publikimi i vendimeve të Autoritetit Publik, që burojnë nga sa më sipër dhe përbëjnë objektin e kërkesës, nuk shkakton asnjë dëm të qartë dhe të rëndë për administrimin e procesit të rivlerësimit. Përkundrazi një qasje në favor të transparencës do ta bënte edhe më të besueshëm për publikun punën e Autoritetit Publik. Në publikimin e Vendimeve, Autoriteti Publik mund të bazohet gjithnjë në pikën 6 të nenit 17 të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" ku përcaktohet se: "*Nëse kufizimi prek vetëm një pjesë të informacionit të kërkuar, pjesa tjetër nuk i refuzohet kërkuarit. Autoriteti*

Publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit që janë refuzuar si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”.

Lidhur me kërkesën e dytë, ku kërkohet numri i çështjeve të regjistruara nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe trupat gjykuese të cilëve i janë shpërndarë çështjet, duke përcaktuar të dhënat për çështjen, trupat gjykuese, kryesuesin e trupës gjykuese dhe relatorin, Autoriteti Publik është shprehur se ai nuk regjistron çështje, por shorton listën e subjekteve të rivlerësimit, për të cilat mbledhja merr vendim. Zyra e Komisionerit vlerëson se për shkak se subjektet të cilat i nënshtrohen rivlerësimit janë të listuara në faqen zyrtare të internetit të Autoritetit Publik, aksesit në to dhe shumatorja e tyre mund të përlllogaritet lehtësisht. Për këtë arsye informacioni konsiderohet i bërë publik dhe kjo pikë nuk ka nevojë për trajtim të mëtejshëm në këtë vendim.

Sa i përket të dhënave mbi trupat gjykuese, kryesuesin dhe relatorin, Autoriteti Publik ka vlerësuar ruajtjen e konfidencialitetit deri në njoftimin e seancës dëgjimore bazuar në nenin 4, pika 7 e ligjit nr.84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë". Kjo për shkak se, në vlerësim të Komisionit, bërja publike e trupës gjykuese përpara mbylljes së hetimit dhe njoftimit të seancës dëgjimore mund të cenojë procesin e hetimit. Lidhur me këtë argument Komisioneri vlerëson se ky informacion nuk lidhet me procesin hetimor, por është pjesë e procedurave administrative të institucionit. Për rrjedhojë publikimi i këtij informacioni nuk cenon procesin.

Për më tepër, duke qenë se ligji nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i referohet Kodit të Procedurave Administrative sa i përket zhvillimit të procesit të rivlerësimit nga ana e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për analogji edhe procesi i shortimit duhet t'i uniformohet praktikës së konsoliduar të gjykatës ku ky proces është transparent dhe trajtohet si një element garancie për paanshmërinë e punës së gjykatës. Nga ana tjetër vetë neni 15 i Rregullores së Autoritetit Publik e miratuar në përputhje me nenin 69, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", e cilëson procesin e shortimit si transparent duke e bërë konfidencialitetin e pretenduar të pambështetur në dispozita ligjore.

Lidhur me kërkesën për datat e seancave dëgjimore për subjektet e rivlerësimit, Autoriteti Publik sqaroi gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale se seanca e parë dëgjimore është caktuar më datë 21.03.2018 dhe do të vijohet me publikimin e tyre.

Komisioneri konstaton se nuk kemi të bëjmë me një vullnet të Autoritetit Publik për refuzim të dhënies së informacionit. Në rastin konkret kemi të bëjmë me një vlerësim të ndryshëm përse i përket parimit të proporcionalitetit në raport me interesin e lartë publik.

Në përmbyllje të shqyrtimit të ankesës dhe konsultimit të legjislacionit përkatës, Komisioneri vlerëson se informacioni i kërkuar përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", i cili përcakton se: "Informacion publik" konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.

Bazuar në pikën 3 të nenit 3 të ligjit të sipërcituar, "Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

Në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga legjislacioni i shqyrtuar dhe përmendur më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se Autoriteti Publik, në bërjen publike të Vendimeve

duhet të ketë në vëmendje nenet 5, 6 dhe 7 të Ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, sa i përket personave të tretë ose atyre të lidhur që citohen në këto Vendime.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Qendra “Lex Ferenda” ndaj Autoritetit Publik, Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, Komisioneri vlerëson se ankesa për të dhënë informacionin e kërkuar duhet pranuar në mënyrë të pjesshme.

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b), c) dhe ç) të pikës 5, të nenit 24, nenit 25, të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18, të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

V E N D O S A:

- 1- Pranimin pjesërisht të ankesës së Qendrës “Lex Ferenda” me nr. 318 Prot., datë 09.02.2018, ndaj Autoritetit Publik Komisioni i Pavarur i Kualifikimit me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
- 2- Urdhërimin e Autoritetit Publik “Komisioni i Pavarur të Kualifikimit”, për dhënie ankesit në mënyrë të pjesshme të informacionit të kërkuar dhe më konkretisht:
 - Kopje të vendimeve të marra nga mbledhja e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në kuadër të veprimtarisë administrative sipas nenit 9 të Rregullores së Brendshme;
 - Bërjen publik të procedurës së hedhjes së shortit dhe trupave gjyquese të dala prej tij sipas nenit 14 të Ligjit nr. 84/2016, brenda datës 06. 4 .2018;
- 3- Rrëzimin e kërkesës përse kërkohet lidhur me: *numrin e çështjeve të regjistruara pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, datat e seancave dëgjimore si dhe parashikimin se kur mund të zhvillohen.*
- 4- Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni, sipas nenit 25 të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
- 5- Ky vendim u shpall sot në datë 26. 3 .2018.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

